

20071151504

L I G J
PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR
INSPEKSIONIN ADMINISTRATIV

Neni 1

Në Ligjin për inspeksionin administrativ (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 69/2004 dhe 22/2007) pas nenit 7 shtohet neni i ri 7-a si vijon:

“Neni 7-a

Inspektori i kryen punët në pajtim me programin vjetor të punës dhe planet operative mujore për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

Programi vjetor dhe planet operative mujore nga paragrafi 1 të këtij neni i miraton drejtori i Inspektoratit dhe ia dërgon ministrit të Drejtësisë.

Drejtori përgatit raport vjetor për punën e Inspektoratit në vitin paraprak dhe ia dërgon nëpërmjet ministrit të Drejtësisë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë më së voni deri në fund të janarit në vitin në vijim.

Raporti vjetor shpallet në veb faqen e Ministrisë së Drejtësisë.”

Neni 2

Në Kreun V shtohen tre nene të reja 15-a, 15-b, dhe 15-v, si vijojnë:

“Neni 15-a

Mbikëqyrjen inspektuese inspektori e kryen nëpërmjet:

- 1) mbikëqyrjes së rregullt inspektuese,
- 2) mbikëqyrjes së çrregullt inspektuese dhe
- 3) mbikëqyrjes kontrolluese inspektuese.

Neni 15-b

Mbikëqyrja inspektuese e rregullt përfshin mbikëqyrjen ndaj zbatimit të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjeve tjera të cilat përmbajnë dispozita për procedurën administrative, si dhe ndaj zbatimit të dispozitave për punën në zyra.

Inspektimi i mbikëqyrjes së çrregullt kryhet në bazë të iniciativave, parashtresave dhe propozimeve të dorëzuara nga organet shtetërore, personat juridikë dhe fizikë, si dhe në rast të dyshimit të inspektorit.

Mbikëqyrja kontrolluese inspektuese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendimin e miratuar nga ana e inspektorit.

Neni 15-v

Mënyrën për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese së afërmi e përcakton ministri i Drejtësisë.”

Neni 3

Në nenin 16 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri, 2 si vijon:

“Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni inspektori kryen edhe mbikëqyrje inspektuese të paparalajmëruar dhe para fillimit të kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar ta informojë funksionarin e organit, respektivisht personin udhëheqës në organin në të cilin kryhet mbikëqyrja për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe të legjitimohet.”

Neni 4

Ministri i Drejtësisë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do ta miratojë aktin nga neni 15-v i këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë prej ditës së shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.